



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 779/5 Prot.

Tiranë, më 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 256, Datë 11.11.2025

Bazuar në nenin 33/11, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar ankesën nr. 20, datë 13.03.2019, të paraqitur nga z. F.A kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), me pretendimin për diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*. Me Vendimin nr. 121, datë 09.09.2019, Komisioneri ka disponuar në lidhje me ankesën, duke vendosur: *“Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit F.A nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të bindjes politike”*. Në pikën 3, të këtij vendimi Komisioneri ka vendosur që: *“Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me z. F.A”*.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 779/2, datë 29.05.2025, drejtuar FSDKSH-së, ka kërkuar zbatimin e Vendimit nr. 121, datë 09.09.2019 të Komisionerit, të lënë

në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin Nr. 736 (86-2025-940), datë 08.05.2025, lidhur me ankesën e z. F.A.

FSDKSH me shkresën nr. 409/4, datë 09.06.2025, në mes të tjerash, informoi Komisionerin se: *“Ndërmjet Avokaturës së Shtetit, kemi paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë ndaj këtyre vendimeve (Vendimit Nr. 736 (86-2025-940), datë 08.05.2025, të Gjykatës Administrative të Apelit), të cilat i kemi konsideruar të pambështetura në ligj e në prova dhe jemi në pritje të një vendimmarrje nga ana e kësaj gjykate.*

Vlen të theksojmë këtu faktin se të njëjtat pretendime nga z. A, kanë qenë objekt gjykimi me shqyrtimin e kërkesë padisë së ngritur prej tij pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në Vendimin nr. 4625, datë 18.02.2018, të kësaj gjykate u vendos rrëzimi i kërkesë padisë, përfshirë dhe kërkesa e z. A për rikthimin në punë. Ky vendim është ankimuar nga paditësi pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe jemi në pritje të shqyrtimit të kësaj çështje.

Ndodhur në kushtet e ekzistencës së dy vendimeve gjyqësore të ndryshme në lidhje me të njëjtin objekt, jemi në pritje të unifikimit të tyre nga ana e gjykatës. Për sa më sipër, në kushtet kur rikthimi në punë për z. F.A është objekt gjykimi në këto gjykata, pika 3 e Vendimit nr. 121, datë 09.09.2019, i KMD-së, do të zbatohet në përputhje me vendimmarrjen e tyre”.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e Vendimit nr. 121, datë 09.09.2019, të Komisionerit, i cili ka marrë formë të prerë dhe është i detyrueshëm për zbatim.

Për rrjedhojë, në mungesë të zbatimit të vendimit dhe bazuar në nenin 33, pikat 11, 12 dhe 13, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri me Vendimin nr. 184, datë 07.08.2025, ka vendosur:

- 1. “Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të gjobitet në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit nr. 121, datë 09.09.2019, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*
- 2..... 3. 4. Zbatimi i Vendimit nr. 121, datë 09.09.2019, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij”.*

Në përgjigje të vendimit të mësipërm, FSDKSH me shkresën nr. 4445/1, datë 18.08.2025, informoi Komisionerin se: *“Në mbështetje të pikës 4 të vendimit, ju bëjmë me dije se në përputhje me kualifikimet dhe arsimimin e z. F.A, në FSDKSH është vakant pozicioni si më poshtë: Specialist ekonomist në Sektorin e Buxhetit pranë Drejtorisë Ekonomike. Njoftohet z. A të paraqitet ditën e enjte në datë 21.08.2025, ora 10.00 për kryerjen e intervistës së strukturuar me gojë për vendin e sipërcituar”.*

Z. F.A me email-in datë 04.09.2025, ka informuar Komisionerin se: *“Ju bëj me dije se në zbatim të shkresës nr. 4445/1, datë 18.08.2025 të FSDKSH, jam paraqitur dhe më është komunikuar punësimi si Specialist Ekonomist në Sektorin e Buxhetit pranë Drejtorisë Ekonomike. Nga diskutimi për plotësimin e kriterëve që kërkoheshin për këtë pozicion pune rezultoi se nuk përshateshin me ato të cilat kam unë në CV-në time. Kemi diskutuar për gjetjen e mundësive të tjera që vendi i punës që do të më ofrohet të përputhet me kriteret që plotësoj unë. Jam në pritje që FSDKSH të marri masa për të zgjidhur këtë problem brenda një afati të pranueshëm”.*

Përsëri z. F.A me email-in datë 05.11.2025, ka informuar Komisionerin se: *“Deri në datën e këtij mesazhi, FSDKSH nuk e ka zbatuar vendimin. Siç ju kam vënë në dijeni, më thirrën dhe më kërkuan t’ju leje pak kohë që të gjejnë vendin e punës që përshatej me kurikulën time (pasi vendi që afruan megjithëse unë e pranova nuk kishte përputhje), kohë të cilën jua lamë në dispozicion e megjithatë nuk u zgjidh problemi.*

Gjatë kësaj kohe u zëvendësua edhe Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH dhe drejtorin e ri e vura në dijeni për problemin, nëpërmjet email-it zyrtar (datë 20.10.2025) të cilin e keni bashkëngjitur, por deri në datën e sotme nuk kam marrë asnjë përgjigje. Pra si përfundim Vendimi KMD nuk është zbatuar nga ana e FSDKSH”.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se ankuesi pretendon moszbatimin e vendimit të Komisionerit, rezulton se FSDKSH, në zbatim të vendimit të Komisionerit, i ka ofruar z. A, vendin e punës në përputhje me arsimimin¹ e tij në pozicionin, Specialist Ekonomist në Sektorin e Buxhetit pranë Drejtorisë Ekonomike dhe ankuesi e ka pranuar atë, por duke ngritur pretendimin se pozicioni i ofruar nuk ishte në përputhje me CV-në e tij.

Bazuar në sa më sipër si dhe mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 33/11, i cili përcakton se: *“....Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”*, Komisioneri arrin në përfundimin se, Vendimi nr. 184, datë 07.08.2025 për vendosjen e sanksionit me gjobë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë ndaj Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33/11 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹ Ankuesi përpara se të largohej nga puna, ka mbajtur pozicionin, Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar.

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit me gjobë nr. 184, datë 07.08.2025, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Të njoftohen palët për këtë vendim.

KOMISIONERI

Robert GAJDA